

Historiku i përmirësimit të bimës së misrit në Shqipëri

Prof.As. Dr. Kostandin Hajkola
QTTB Shkodër

Numri i madh i popullatave është i lidhur me faktin se rrugët e introduktimit të tyre kanë qene te ndryshme, nga lindja dhe nga perëndimi. Hapat e pare te **seleksionimit** me bimen e misrit jane zgjedhjet empirike bazuar ne “shenjterimin e fares”. Fara e misrit tradicionalisht perpunohet ne vecanti, ndahej dhe nuk prekej qofte edhe per aresye madhore.

Zona dhe fshatra te vecante kishin popullatat e tyre. Me kete fare konsolidonin edhe praktiken e kultivimit duke synuar vjeljen e kapacitetit te saj. Shperndarja dhe vleresimi i “performances” se ketyre farave kryhej nepermjet lidhjeve fisnore apo miqesore, gjithnje ne funksion te zgjedhjes se asaj popullate qe jepte prodhim te larte e te qendrueshem.

Numri me i madh i popullateve ndeshet ne zonat malore. Kjo per faktin e nje diversiteti me te madh te faktoreve klimatike por edhe praktikave te kultivimit. Dominojne popullatat lokale me cikël te shkurter, strukture qelqore te kokrres. Ngjyra e kokrres dominuese eshte e verdha.

Deri ne vitet 50 te shekullit te kaluar, këto popullata kane qene baza te kultivimit te misrit ne Shqipëri. Fillimet e para të seleksionimit shkencor te popullatave i gjejmë ne vitet 30, ne teknikumin bujqësor Lushnjë. Është punuar kryesisht mbi popullatat **Sulove** e **Yzberish**, si me te përhapurat ne zonën e ulet fushore. Ne vitet e luftës se dyte botërore deri ne vitet 50, disa shkencëtare te huaj janë marre me koleksionimin e popullatave dhe ruajtjen e tyre ne qendrat e resurseve gjenetike, ne Gjermani, ish Jugosllavi dhe ish BS ne Shën Peterburg. Pas viteve 50 te shekullit te kaluar, ka filluar vlerësimi paraprak dhe përdorimi i popullatave lokale ne krijimin e hibrideve te para të tipit Top-cros.

Ne vitet 60, ne strukturën e mbjelljeve te misrit kane dominuar popullatat e përmirësuara nëpërmjet zgjedhjes individuale apo masive, si dhe hibridet top-cros me prejardhje, popullate lokale x hibrid i huaj. Hibride me baze popullate x popullate nuk kane patur sukses pasi heterozin ne këto raste ka qene i ulet, qe nuk justifikonte shpenzimet për prodhimin e farës. Vetëm ne vitet 70 u be e mundur te kalohet ne kultivimin e misrave hibrid ndërmjet linjave inbrede. Ne vitin 1977, për here te pare Shqipëria ka mbjelle 99 % te sipërfaqes se misrit me fara hibride.

Linjat kane qene kryesisht te huaja, mirëmbajtja dhe shumëzimi i tyre është kryer ne institucione kërkimore (IMO dhe ILB). Prodhimi i farës hibride realizohet ne ekonomi te prodhimit te farave, përpunimi dhe shpërndarja behej nga ndërmarrjet e farave. E gjithë kjo infrastrukture ka vazhduar te funksionojte deri

ne fillim te viteve 90. Nga ana tjetër, institucionet kërkimore te mësipërme me programe te mirëfillta kërkimore, aplikonin skema seleksionimi qe rezultonin me krijimin e linjave dhe hibrideve te reja, me kapacitet prodhues e përshtatshmëri te larte për kushtet e Shqipërisë. Ne këto programe janë përfshire edhe popullata lokale si germoplazme fillestare ne krijimin e linjave te reja.

Ne përgjithësi linjat me prejardhje nga popullatat lokale kane shfaqur mjaft dobësi. Aftësia e ulet kombineve, vitaliteti i ulet pas 4-5 incukteve, rrëzimi ne vegetacion, aftësi prodhuese e ulet si komponentë prindëror kane qene disa karakteristika “negative” qe përjashtonin përdorimin e tyre direkt. Megjithatë, me metoda te ndryshme seleksionimi (rikryqëzimet, krijimi i pool-ve sintetike), këto linja me origjine popullata lokale janë përfshire ne formulat e hibrideve te thjeshte apo tre linjesh. Këtu mund te përmendim, Rozafa 113 B, Rozafa 116 B etj.

Tradicionalisht, misri ne Shqipëri është kultivuar dhe shfrytëzuar kryesisht si drithë buke. Tani ky destinacion është ne përmasa te kufizuara, kryesisht ne disa zona malore te vendit. Megjithatë konstatohen qe edhe ne zona tjera preferohet konsumi human i misrit (kryesisht si buke misri).

Si ne shume vende te botes edhe ne Shqipëri misri konsiderohet një kulture bujqësore me mjaft interes. Fale kushteve te favorshme pedoklimatike (me përjashtim te reshjeve) kultivimi tij është shtrire nga bregu i detit deri ne lartësitë 1000 m mbi nivelin e tij ne sipërfaqe qe ka arritur nga 100-150 mije ha. Rendimenti ne shkalle vendi para përdorimit te farave hibride ka qene i ulet, ne nivelet 1.5-2.0 ton/ha. Pas futjes se farës hibride, rendimenti është 2-3 fishuar, natyrisht duke aplikuar teknologji me efikase.

Ne 20 vitet e fundit Shqipëria mbjell rreth 55 mije ha dhe realizon një prodhim 4.5-5.5 ton/ha. Rendimenti maksimal është i vitit 2010 dhe ka arritur 6.7 ton/ha. Një nga tendencat pozitive te këtyre 10 viteve te fundit është zgjerimi i sipërfaqes se mbjelljes se misrit me destinacion silazh me kalli. Si një nga format e konsumit maksimal te vlerave qe ka bima e misrit, kjo praktike e kultivimit ka tendence te zgjerohet edhe për faktin e një sipërmarrje me te madhe te rritjes e mbarështimit te blegtorisë, kryesisht gjedhit.

%